



**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE**

---

# **PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 18-24 MUAJ** **MUAJI NËNTOR**



**PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS**

 Fëmijët e Tiranës

<http://femijetetiranes.al/>

 femijet\_e\_tiranes

## Kuriozitete për Muajin Nëntor



### Çfarë mund të dimë për Nëntorin?

- \* Muaji Nëntor është **muaji i tretë** i vjeshtës.
- \* Në Nëntor, **ditët bëhen më të shkurtra dhe më të ftohta** se ditët në Tetor.
- \* Frutat si **mandarinat, portokallet, shegët, hurmat**, ne nisim t'i shijojmë në Nëntor.
- \* Nëntori është **muaji i Të Drejtave** të fëmijëve.
- \* Nëntori është **muaji i festave kombëtare** të vendit tonë: Dita e Pavarësisë dhe Dita e Çlirimit.

## Muaji Nëntor

### Tema: Njohja e Vetes dhe Të Drejtat e Fëmijëve

Grupmosha 18-24 muaj



- \* **Java I:** Njohja e vetes
- \* **Java II:** Veshjet për fëmijët
- \* **Java III:** Të drejtat e fëmijëve
- \* **Java IV:** Festat dhe festimi i tyre



---


### Tema e Muajit: Njohja e Vetes dhe Të drejtat e Fëmijëve



Tema Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Njohja e vetes	Njohja me elementët e vetes	Java I
Lodrat dhe veshjet e fëmijëve	Njohja me veshjet për fëmijë	Java II
Të drejtat e fëmijëve	Njohja me të drejtat e fëmijëve	Java III
Festat dhe festimi i tyre	Festojmë festat së bashku	Java IV





- \* Stafi edukator duhet të marrë pjesë në çdo aktivitet dhe temë ditore bashkë me fëmijët.
- \* Stafi i praktikon aktivitetet në bazë të zhvillimit dhe interesave të fëmijëve.
- \* Stafi duhet të informojë prindërit mbi temën mujore dhe javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.

## Tema e Muajit: Njohja e Vetes dhe Të Drejtat e Fëmijëve

### Tema e Javës: Njohja e Vetes



Java I	Tema	Aktivitetet	Mjetet
<b>E Hënë</b>	<b>Fytyra ime</b> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatorja tregon me gisht shqisat në fytyrën e saj dhe i emërton ato, pastaj stimulon fëmijët t'i prekin te kukulla/arushi dhe në fytyrat e tyre. Edukatorja pyet fëmijët: <i>Ku është syri/hunda/goja/veshi? Ku është goja, Ana?</i></p> <p><b>Loja me pasqyrë:</b> E vendosim fëmijën përballë pasqyrës dhe i prekim me gisht pjesët e fytyrës, duke i emërtuar ato. Nxisim fëmijët të bëjnë të njëjtën gjë.</p> <p><b>Punë dore:</b> “Krijojmë pjesët e fytyrës”  Në një fletë bosh, vizatoni një rreth për fytyrën; vizatoni/printoni shqisat dhe ngjitini ato te fytyra bashkë me fëmijët (foto djathtas).</p> <p><b>Vjersha:</b> “Këtu jam unë”</p> <p><i>Shënim: Kërkojmë bashkëpunimin e prindërve për të sjellë foto të fëmijëve për aktivitetin e të premtës.</i></p>	<p>Kukulla, arusha, pasqyrë, fleta, lapsa me ngjyra, gërshërë, ngjitës</p> 

<p><b>E Martë</b></p>	<p><b>Trupi im</b></p> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatorja u tregon fëmijëve pjesët e trupit (te vetja, te kukulla/aurshi, pastaj me radhë te fëmijë të ndryshëm).</p> <p><b>Lojë:</b> “Arushi thotë...” Edukatorja ul në rreth fëmijët dhe me anë të një arushi që i vendos një emër, jep komanda të thjeshta. P.sh., Arushi Abi thotë: “Preke kokën! Hunda pip-pip! Duart lart! Duart poshtë! Preke këmbën! Ku është barku?” Etj.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Këtu jam unë”</p> <p><b>Këngë lëvizore:</b> “Nëse ti je i lumtur...”</p>	<p>Kukulla, arushë</p> 
<p><b>E Mërkurë</b></p>	<p><b>Në pasqyrë jam Unë!</b></p> 	<p><b>Ushtrime:</b> Nxisim fëmijët të lëvizim pjesët e trupit përmes ushtrimeve gjimanstikore.</p> <p><b>Bisedë:</b> Edukatorja u kujton fëmijëve shqisat dhe pjesët e trupit, duke treguar me gisht dhe emërtuar (demonstrim me fëmijët, arushat, kukullat).</p> <p><b>Loja me pasqyrë:</b> Vendosim fëmijët para pasqyrës dhe i nxisim të tregojnë pjesët e fytyrës dhe trupit.</p> <p><b>Loja:</b> “Gjurma e dorës/këmbës” Paraprakisht, edukatorja përgatit brumë dhe e hap në një sipërfaqe të sheshtë, pastaj i nxit fëmijët të vendosin duart dhe këmbët për të lënë gjurmë. Gjurmët mund të ngjyrosen sipas dëshirës.</p>	<p>Pasqyrë, miell/ brumë, penela</p> 




<p><b>E Enjte</b></p>	<p><b>Emri im</b></p> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatorja i ul fëmijët në rreth dhe i thërret në emër. Pastaj e shoqëron me hedhje-pritje topi: Edukatorja ia hedh topin Siarit dhe thërret: “Topin e ka Siari!” e kështu me radhë.</p> <p><b>Lojë:</b> “Gjej shokun/shoqen” Gjatë ditës edukatorja u kërkon fëmijëve të gjejnë dhe të tregojnë me gisht (ose të prekin/ përqafojnë) njëri-tjetrin: “Abi, ku është Dea?”</p> <p><b>Vizatim i lirë:</b> U japim fëmijëve fletë dhe lapsa me ngjyra dhe i lëmë të vizatojnë sipas dëshirës. Në fund, vendosim emrin e fëmijës në çdo fletë dhe ua tregojmë fëmijëve duke e vënë theksin te emri: “Ky është vizatimi i Borës!”</p> <p><b>Përrallë e lirë.</b> Zgjedhim një përrallë dhe ua lexojmë fëmijëve. Emërtojmë personazhet.</p>	<p>Top, letra, lapsa me ngjyra, libër me përralla</p> 
<p><b>E Premte</b></p>	<p><b>Albumi i grupit</b></p> 	<p><b>Aktivitet:</b> Me fotot e mbledhura gjatë javës, krijojmë një album të grupit dhe poshtë fotove shënojmë emrat e fëmijëve. Përsërisim pjesët e fytyrës dhe të trupit.</p> <p><b>Përsëritje:</b> Vjersha “Shqisat”, “Këtu jam unë”, këngët lëvizore</p> <p><b>Lojë sensore:</b> Improvizojmë tinguj të ndryshëm që fëmijët t’i dëgjojnë dhe emërtojmë cilësitë e tingujve “i fortë, i butë; i lartë, i ulët”. Përfshijmë edhe shqisat e tjera: prekja, nuhatja, shikimi. Mund të përdorim shishe plastike dhe t’i mbushim me oriz, makarona, rërë, ujë, etj.</p>	<p>Fotografi të fëmijëve, materiale të ndryshme në grup, shishe plastike, etj.</p> 





<p><b>E Martë</b></p>	<p><b>Rrobat e mia</b></p> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatorja u flet fëmijëve për veshjet, duke e konkretizuar bisedën me veshjet e fëmijëve. Emërton pjesët e veshjes, ngjyrat, materialet e tyre. I nxisim fëmijët të prekin dhe të emërtojnë veshjet e tyre.</p> <p><b>Punë dore:</b> Edukatorja vizaton bluzë/ fund/ pantallona ose pjesë të tjera të veshjeve dhe i pret ato me gërshërë. Pastaj i ndihmon fëmijët të ngjisin copëza letrash të prera me ngjyra të ndryshme mbi modelet e krijuara (ose mjete të riciklueshme).</p> <p><b>Loja:</b> Veshja-zhveshja e arushit/kukullës</p> <p><b>Vjersha:</b> “Jam një vajzë simpatike/ “Çdonjëri prej nesh është i bukur”.</p>	<p>Fleta me ngjyra, lapsa, gërshërë, ngjitës, arush, kukull</p> 
<p><b>E Mërkurë</b></p>	<p><b>Rrobat e arushit</b></p> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatorja iu tregon fëmijëve veshjet e arushave dhe kukullave që ndodhen në grup: bluza/ pantallona/ fustan/ kapele/ shall, etj. Edukatorja pyet: Çfarë ka veshur kukulla/arushi?</p> <p><b>Loja:</b> “Kukulla që vishet” Edukatorja ndihmon fëmijët të veshin dhe zhveshin kukullat/ arushat.</p> <p><b>Vizatim/Ngjyrosje:</b> “Veshje për kukulla/arusha”</p> <p><b>Përrallë:</b> “Hirushja” (ose një përrallë tjetër nga librat që keni në grup)</p>	<p>Arusha, kukulla, fleta, lapsa me ngjyra</p> 







<p><b>E Enjte</b></p>	<p><b>Lojëra senso- motorike</b></p> 	<p><b>Loja 1: Mbledhim topat</b> Me anë të një ngjitësi, të cilin e vendosim në gjatësinë e fëmijës nga njëra anë e murit në tjetrën, ngjisim topa të vegjël, të cilët fëmijët duhet të ngrihen në majë të gishtave për t'i kapur. Gjatë kësaj loje, praktikojmë edhe emrat ku edukatoret thërrasin fëmijët në emër, sipas radhës, për të kryer lojën (foto majtas).</p> <p><b>Loja 2: Lojë me pipa</b> Fëmijëve iu jepen pipa me ngjyra të ndryshme dhe iu tregohet sesi duhet t'i futin ato brenda në shishe. Më pas i lëmë fëmijët ta bëjnë vetë lojën me ritmin e tyre (foto djathtas).</p>	<p>Topa, pipa, shishe/bikerina</p> 
<p><b>E Premte</b></p>	<p><b>Dita e Edukatores</b></p> 	<p><i>Edukatoret mendojnë vetë për aktivitetet që do të organizojnë sot.</i></p> <hr/> <hr/> <hr/>	

## Tema e Muajit: Njohja e Vetes dhe Të drejtat e Fëmijëve

### Tema e Javës: Të drejtat e Fëmijëve





Java III	Tema	Aktivitetet	Mjetet
<b>E Hënë</b>	<b>Të drejtat e mia</b> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatorja iu flet fëmijëve për disa nga të drejtat që ata gëzojnë: “Ju keni të drejtë të keni një emër/një familje/të luani/të mbroheni, të mos lëndoheni, etj.”</p> <p><b>Vjersha:</b> “Të drejtat e fëmijëve”  <b>Aktivitet:</b> “Pema e Të Drejtave”</p> <p><b>Lojëra me rrrathë</b> (tunnel/ kërcim/ hedhje topi)</p>	<p>Fleta me ngjyra, lapsa, kartona, rrrathë</p> 
<b>E Martë</b>	<b>Kam të drejtë të kem një emër</b> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatorja u thotë fëmijëve se kur lindim, prindërit na vënë një emër. Të gjithë fëmijët duhet të thirren në emër. Edukatorja thërret çdo fëmijë në emër dhe e bën këtë në formë loje ose duke e shoqëruar emrin me melodi të ndryshme.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Të drejtat e fëmijëve”  <b>Lojë:</b> “Loja e telefonit”  Edukatorja bën sikur flet në telefon me fëmijët, duke thirrur emrat p.sh: Alo, Mei! Alo, Enis!</p>	<p>Telefona lodër, lodra dhe mjete të ndryshme në grup</p> 

<p><b>E Mërkurë</b></p>	<p><b>Kam të drejtë të kem një familje</b></p> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatorja iu flet fëmijëve për familjen dhe anëtarët e saj: prindërit/motra/vëllai/gjyshi/gjyshja. Në familje marrim dashuri dhe ngrohtësi.  <b>Vjersha:</b> “Familja”  <b>Përralla:</b> “Mama dhia dhe kecat”  <b>Pikturim me gishta:</b> “Familja e gishtave”  Krijohet gjurma e dorës së fëmijës në letër dhe secili gisht emërtohet si: babi, mami, motra, vëllai).  <b>Kënga:</b> “Familja e gishtave”</p>	<p>Libër me përralla, bojëra, penela, letra</p> 
<p><b>E Enjte</b></p>	<p><b>Kam të drejtë të luaj</b></p> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatorja iu tregon fëmijëve që çdo fëmijë ka dëshirë dhe të drejtë të luajë. Fëmijët duhet të kenë lodra dhe vend për të luajtur brenda dhe jashtë (në shtëpi, çerdhe, parqe etj).  <b>Vjersha:</b> “Të drejtat e fëmijëve”  <b>Lojë:</b> “Loja e Ekuilibrit”  Edukatorja bën vija të drejta në dysHEME (me shirit/ me spango) dhe i nxit fëmijët të ecin duke ruajtur ekuilibrin. Mund të krijoni vija zig-zage dhe në fund të vijës vendosen lodra/ objekte të ndryshme që fëmijët t'i marrin (foto djathtas).</p>	<p>Shirita ngjitës, spango, lodra</p> 
<p><b>E Premte</b></p>	<p><b>Festimi i Konventës së të Drejtave</b></p> 	<p><b>Ekspozimi i punimeve</b> të krijuara gjatë javës.  <b>Bisedë:</b> Përsëritja e të drejtave të fëmijëve.  <b>Aktivitet në grup:</b> Këngë, recitime, kërcim.</p>	<p>Punimet e realizuara nga fëmijët</p> 



## Tema e Muajit: Njohja e Vetes dhe Të drejtat e Fëmijëve

### Tema e Javës: Festat dhe festimi i tyre



Java IV	Tema	Aktivitetet	Mjetet
<b>E Hënë</b>	<b>Njohja me festat</b> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatorja iu tregon fëmijëve për disa nga festat kryesore që festojmë si: ditëlindja, 1 Qershori, Viti i Ri, etj. Edukatorja gjen cili nga fëmijët e ka festuar ditëlindjen në çerdhe dhe cili do ta ketë tani afër. Përdoren foto nga ditëlindjet për të pasuruar bisedën me fëmijët.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Gëzuar ditëlindjen, Elonë”</p> <p><b>Këngë:</b> “Bufi bëri dasëm” (të shoqërohet më lëvizje/ të nxiten fëmijët për të imituar veprimet)</p> <p><b>Lojë:</b> Me tullumbace. Disa tullumbace mund të fryhen pjesërisht, të mbushen me ujë dhe fëmijët të nxiten për të luajtur në mënyra të ndryshme me to.</p>	<p>Artikuj festivë (tullumbace, kapele, kartolina), libra, revista për ilustrim</p> 

<p><b>E Martë</b></p>	<p><b>Festimi i ditëlindjes</b></p> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatorja iu tregon fëmijëve si mund të festohet një ditëlindje. Si vishemi? Çfarë dhurate i bëjmë shokut/shoqes? Si e zbukurojmë dhomën? Si argëtohemi? (përdorim foto të ditëlindjeve në grup).</p> <p><b>Vjersha:</b> “Gëzuar ditëlindjen, Elonë”</p> <p><b>Këngë:</b> “Kënga e ditëlindjes” (Shumë urime për ty!)</p> <p><b>Punë dore:</b> “Kartolina e ditëlindjes” Edukatorja përgatit një model kartoline dhe e zbukuron me fëmijët me elementë të thjeshtë p.sh. shenja gishtash, ngjitje kopsash, etj.</p>	<p>Fleta me ngjyra, lapsa, mjete dekorative (kopsa, fjongo)</p> 
<p><b>E Mërkurë</b></p>	<p><b>Festat e Nëntorit</b></p> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatorja iu tregon fëmijëve për Festat e Nëntorit. Edukatorja i njuh fëmijët me flamurin dhe emërton ngjyrat e tij. Nxiti fëmijët të tregojnë flamurin dhe ta emërtojnë atë.</p> <p><b>Vizatim/ Ngjyrosje:</b> Ngjyrosja nga fëmijët e modeleve të përgatitura më parë nga edukatoret.</p> <p><b>Lojë:</b> “Ngjitja e flamujve në shiritin ngjitës” Në lartësinë e fëmijës vendoset një shirit ngjitës dhe fëmijët nxiten të ngjisin flamujt në të. Loja mund të bëhet edhe me topa të vegjël.</p>	<p>Letra me ngjyra të kuqe/të zezë, flamuj të vegjël, topa, shirit ngjitës</p> 

<p><b>E Enjte</b></p>	<p><b>Zbukurimi i çerdhes për festa</b></p> 	<p><b>Punë dore:</b> “Flamuj për festa” (shoqëruar me numërimin dhe dallimin: “i madh”/ “i vogël”).</p> <p><b>Aktivitet:</b> Edukatore-fëmijë bashkarisht zbukurojnë grupet me flamujt e përgatitur, me tullumbace dhe elementë të tjerë festivë.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Flamuri”</p> <p><b>Këngë dhe kërcim:</b> “Këngët për flamurin”</p>	<p>Flamuj prej letre/rrobe, tullumbace, shirita, etj.</p> 
<p><b>E Premte</b></p>	<p><b>Festimi i Festave të Nëntorit</b></p> 	<p><b>Ekspozitë:</b> “Festat” Ekspozojmë punimet e javës (mbi tavolinë, në mur, në korridor).</p> <p><b>Këngë, kërcime dhe valle</b> për festën.</p> <p><b>Sfilatë:</b> Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit që fëmijët të vishen kuq e zi ose me kostume popullore. Përgatitja e një sfilate të thjeshtë në grup.</p>	<p>Punimet e javës, veshje kuq e zi, flamuj</p> 